

Procesverbal i Kuvendit Statutor të FBK-së

Më 01 tetor 2022, Prishtinë

Rendi i Ditës

1. Zgjedhja e trupave punues
 - Kryesia e punës
 - Komisioni verifikues
 - Procesmbajtësi
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendi të Punës i datës 26.03.2022
3. Ndryshimet në statutin e FBK-së

Hyrje

Kuvendi Statutor i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) u mbajt më 01 tetor 2022 në hotelin "Garden" në Prishtinë. Kuvendi filloi në ora 11:00 dhe u kryesua nga Kryetari i FBK-së, z. Arben Fetahu në prani të Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, z-njës Elvira Dushku. Delegatë të pranishëm në sallë ishin 32, që nënkupton se kishte kuorum të mjaftueshëm për të mbajtur Kuvendin Statutor (2/3 e delegatëve).

Të pranishmit miratuan rendin e ditës të Kuvendit Statutor me aklamacion.

U formuan Kryesia e punës, komisioni verifikues dhe u caktua procesmbajtësi.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së, Shaqir Totaj, njoftoi delegatët për takimin e mbajtur me Sekretaren e Përgjithshme dhe frymën e mirë të punës që po mbizotëron në Federatë. Ai konstatoi se në bazë të gjetjeve, Federata respekton çdo rregullore dhe rregull në fuqi dhe se Federata është për çdo lëvdatë. Sipas tij, nuk ka asgjë të jashtëzakonshme për të raportuar.

Miratimi i procesverbalit

Delegatët miratuan procesverbalin pa asnjë vërejtje.

Ndryshimet në statutin e FBK-së

Në bazë të Nenit 16 të Statutit të FBK-së, pika 2: *"Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve të Kuvendit. Vendimet konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar më shumë se gjysma e delegatëve të pranishëm në mbledhje. Përfundimisht kësaj dispozite, ndryshimi i këtij Statuti dhe vendimi për pushimin e veprimtarisë së Federatës do të bëhet nga 2/3 e delegatëve të Kuvendit. Votimi në Kuvend është publik, përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe".*

Kjo nënkupton se numri i delegatëve të pranishëm në Kuvendin Statutor të datës 01 tetor i mundëson FBK-së të vazhdojë me procedurat e përbashkëta FBK – MKRS.

Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, lexoi secilën pikë të propozim ndryshimeve në Statutin e FBK-së. Ai përmendi tri rregullohet që janë punuar dhe miratuar nga Bordi i FBK-së: *Rregullorja Anti-Doping, Rregullorja për Shpalljen e Laureatëve dhe Kodi Etik*. Ai tha se në parim të tri rregulloret janë të miratuara, por hyjnë në fuqi pasi të hynë në fuqi ndryshimet statutore.

Kryetari Fetahu tha se Neni 22.2 aktualisht të ndryshohet në *Komision Disiplinor të Ankesave*, pastaj në Nenin 42 (propozim ndryshimi 5) të shtohet fjala *bashkëpunojnë ngushtë*, pastaj Neni 39.2 (propozim ndryshimi 7) të modifikohet *pasuria bartet në MKRS – Departamenti i Sportit*.

Kryetari Fetahu përmendi se secili propozim ndryshim është miratuar unanimitisht nga Bordi i FBK-së, por është një kusht formal i dhënë nga MKRS-ja, sepse Federata e Basketbollit e Kosovës është ndër të parat që i plotëson kushtet e parashtruara.

Pastaj, Kryetari Fetahu kërkoi nga delegatët që nëse është e nevojshme të bashkëpunojnë me stafin e FBK-së për licencimin e klubeve ta bëjnë këtë, sepse kriteret e parashtruara nga MKRS-ja janë shumë të rrepta dhe se Komisioni Verifikues për Licencimin e Klubeve është mjaft këmbëngulës në përmbushjen e tyre. Nëse klubet e basketbollit nuk i përmbushin kriteret e parashtruara, ato nuk do të kenë mundësi të përfitojnë nga Ministria, përkatësisht nga paraja publike, prandaj, Kryetari Fetahu kërkoi që të gjithë të jemi të vetëdijshëm/të vëmendshëm në mënyrë që në javët/muajt në vijim të përmbylim edhe këtë obligim. Ai i përkujtoi delegatët se mos-përmbushja e kriterëve të licencimit është pengesë funksionale.

Kryetari Fetahu tregoi se Federata nuk ka paraparë që të mbahet ndonjë Kuvend për këtë vit, por meqë MKRS-ja insistoi, stafi i FBK-së i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme ta mbajë në kohën rekord.

Risi për këtë vit, sipas Kryetarit Fetahu është Rregullorja Anti-Doping, ku përveç fushatave vetëdijësuese, basketbollistët/basketbollistet do t'iu nënshtrohen testeve për doping. Ai tha se këtë vit do të ketë edhe dhomë anti-doping sepse si FBK-ja, ashtu edhe MKRS-ja dhe Kosova në përgjithësi, janë të interesuara të kenë një komunitet të pastër dhe larg dukurive negative.

Kryetari i Komisionit Vlerësues për Kriteret e Licencimit të Federatave Fidan Shatri foli për rëndësinë e licencimit, në veçanti tha të merren parasysh ligjet dhe Udhëzimi Administrativ për aplikim në MKRS. U përmend fakti se qysh nga viti 2019 është kërkuar nga klubet e basketbollit të harmonizojnë/përditësojnë statutin. Sipas Ligjit në fuqi, nuk lejohet që një zyrtar në një klub të basketbollit të ushtrojë më shumë se një funksion zyrtar në klub.

Zt. Shatri e përmendi edhe çështjen e obligimeve tatimore që klubet mund të kenë në ATK. Ai iu tha delegatëve se klubet e basketbollit duhet të kenë shumë kujdes sepse nëse kanë ndonjë obligim të pashlyer në ATK, aplikimi i tyre për licencim nuk procedohet tutje. Ai e përmendi se i vjen shumë mirë që është i pranishëm në Kuvendin e FBK-së për shkak të lidhjes së tij që e ka me basketbollin sepse dëshiron të shoh klubet të licencohen pa asnjë pengesë.

Kryetari Fetahu pyeti delegatët se a kanë ndonjë vërejtje ose ndonjë gjë për të shtuar në lidhje me propozim ndryshimet. Meqenëse nuk pati asnjë vërejtje, delegatët i miratuan të gjitha propozim ndryshimet unanimitisht.

Përmbyllja e Kuvendit Statutor

Kryetari Fetahu i falënderoi të gjithë të pranishmit dhe i ftoi për një drekë të përbashkët. Në përmbyllje, Kryetari Fetahu tha se Federata e Basketbollit e Kosovës është në trajektore të mirë edhe më tutje.

Kuvendi përmbylli punimet në ora 11:50.

Përgatiti:

Vlora Braha

Procesmbajtëse

Miratoi:

Arben Fetahu

Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës